



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 25

Datë: 05. 06. 2017, ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.

2. Aktivitetet e ZRPP-së.

- Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 25 -të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për rend dite, e kemi vetëm një pikë faktikisht, por më duket që kemi edhe një propozim....Po, urdhëro Betim...!

Betim Gjoshi: Realisht, unë para se me bërë propozimin, kisha dashtë me ditë se Sekretariati, a na ka pru ndonjë analizë për pikë të rendit të ditës. E dyta, nëse sot nuk na ka pru, a është i

gatshëm që nesër të paktën, deri në mesditë me na e sjellë se më, nuk ka edhe kuptim ajo pjesë. E treta, nëse asnjë nga këto nuk ekzistojnë, a duhet na ta marrim një qëndrim si Komision Qendror Zgjedhor, e këta me vepruar sipas saj...Ndoshta, është mirë një përgjigje nga krye shefi para se me miratuar rendin e ditës ka të bëjë me numërimin.

Sami Hamiti: Faleminderit, një përgjigje nga ekzekutivi, nga sekretariati...! Sot, a mund ta bëjnë a nuk mund ta bëjnë...! Sot, ta kemi një qëndrim, mos të lejojmë të shtyhet se, është që një javë që e kemi dhënë propozimin. Dhe, nuk ka kurrfarë element fillestar inicial se çka do të bëhet. Një propozim që ka ardhur nga kolegu edhe që është përkrahur unanimisht, është përkrahur edhe këtu nga ne..., prandaj nëse nuk mund ta bëni, tregoni në mënyrë që KQZ-ja të merr një vendim. Kaq...

Valdete Daka: Urdhëro Bajram ?

Bajram Ljatifi: Ndoshta, në këtë kohë edhe po e rëndojmë Sekretariatit...Ne, duhet të marrim qëndrim. E kemi ligjin, aktet, nën aktet, praktikën dhe, duhet të marrim qëndrim që të mbrojmë edhe votën e partive, edhe votën e kandidatëve...

Valdete Daka: Sekretariati këto punë i ka!

Enis Halimi: Ne prej momentit kur kemi marr një imput të këtillë që ka rrjedh në mbledhjen e KQZ-së, ne kemi shqyrtuar mundësit tona të gjitha natyrave, dhe kemi diskutuar me IF- in. Janë disa ide në kuptimin jo tërësisht të ezaurume deri në fund. Tash..., nuk po di..., për ta diskutuar sot..., nuk është se kemi ndonjë ide, dokument për ta diskutuar në ndonjë format adekuat...E kemi analizuar edhe doracakun dhe rregullativën tjetër, dhe jemi konsultuar edhe me IF-in por nuk është se kemi ide tash për tash në këtë moment, ide të qartë për ta shtjelluar me saktësinë që kërkon kjo procedurë...

Valdete Daka: Ma shkurt nuk keni propozim...!

Enis Halimi: Deri tash, jemi ende në konsultime...

Valdete Daka: Më 11 janë zgjedhjet, dhe duhet me ua dërguar këtë qëndrim edhe KVV-e...

Binak Vishaj: Faleminderit shumë për fjalën kryetare...Kërkesa e Betimit, është një kërkesë edhe një shqetësim i përbashkët i krejt Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe, ka marrë përkrahjen e gjithëve. Mendoj edhe konsideroj se meqë edhe sekretariati e ka të njëjtën sfidë, këtë pjesë që ne po e kërkojmë të bëjmë diçka, të paktën të provojmë....!

Ajo që m2 e pakta ne mundemi të bëjm2, tha z. Vishaj, është që ta shpërndajmë një njoftim ose, si me quajt një qarkore që e bëjmë me dije që sikur se mu prek subjektet politik, njëjtë është e dënueshme dhe e pa tolerueshme prekja e besimit ndaj kandidatëve, d.m.th, njëjtë, është cenimi i integritetit dhe i procesit zgjedhor, dhe i besimit të qytetarit ndaj votës së vet. Këta, munden të paktën, ose nëse ka ndonjë propozim që është më adekuat, më i mirë dhe ma mirë, por mendoj që diçka duhet me bo...Edhe Betimi, ka pasur të drejt që vazhdimisht që disa mbledhje, e përsërit të njëjtën kërkesë. Edhe nëse sot nuk bëhet, për mua është e pa kuptimtë, është shumë vonë..., atëherë, sot është e hënë dhe nuk e di kur mundemi me bo pastaj...

Betim Gjoshi: Pra, e fusim në rend të ditës: masat që Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të marrë për të siguruar numërimin e saktë të votave. Dhe, gjatë tyre, e diskutojmë e që e bëjmë më të saktë nëse na mbetet diçka pa plotësuar si dokument, dhe për nesër plotësohet...

Valdete Daka: Mirë, atëherë kush është për këtë propozim, dhe për rendin e ditës, dhe për këtë propozim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë propozim dhe rendin e ditës.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve

Miradije Mavriqi: Faleminderit kryetare. Të nderuar anëtarë të KQZ-së, Zyra ka përgatitur deri më sot, 5 qershor aplikacionet e vëzhguesve të 1 partie politike, 3 institucione ndërkombëtare, 1 instucionit të pavarur, 2 organizatave ndërkombëtare dhe 5 organizatave jo qeveritare, 10 aplikacione të mediave. Për 1.437 vëzhgues, janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara sipas nenit 54 dhe 55 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe sipas nenit 3 të Rregullës Zgjedhore nr. 07 “Vëzhguesit e zgjedhjeve”.

Zyra, tha z. Mavriqi, konstaton se dokumentacioni i aplikimit për akreditim është i kompletuar dhe, i rekomandon të akreditohen këta vëzhgues. E keni tabelën e emrave të organizatave vëzhguese, si dhe emrat e secilit vëzhgues...

Valdete Daka: Faleminderit. Kush është që të akreditohen këta vëzhgues, si më poshtë në tabelë...?

Anëtarët e KQZ-së, akredituan me vota unanime 1.437 vëzhgues

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër e ajo është se si...

Betim Gjoshi: Unë nuk kam diçka me shtuar më shumë se sa në mbledhjen e parë kur kam propozuar. Pra ka qen arsyeja pse e kam kërkuar të tillë, është një shqetësim i gjithë neve dhe gjithë shoqërisë ne të paktën në zgjedhjet e 2013-2014 Komisioni Qendror Zgjedhor ka mbërritur një standard sa i përket votave për subjekte politike. Nuk jem ballafaquar as me ankesa e as nuk jemi ballafaquar me ndonjë problem edhe gjatë rinumërimit mos barazim të votave sa i përket subjekteve politike. Por jo e njëjta ka ndodhur sa i përket kandidatëve, kjo nuk do të thotë që ne po kërkojmë me tërheq vëmendjen prej pjesës subjekteve ne po kërkojmë veç trajtimin e votave të kandidatëve dhe subjekteve në të njëjtën mënyrë ashtu siç i trajton edhe ligji edhe unë në mbledhjen e kaluar, ju e dini që e kam propozuar disa, dhe është mbetur që sektoriati të bëjë një analizë edhe kolegët tan kanë pasur po ashtu disa ide, unë idetë e mia kanë qenë të konkretizuar për tri mundësi, e para ka qen që ne ta dërgojmë se si në vend 2.497 vendvotime që kemi nga një person i cili mund të zgjidhet me short brenda punonjësve ta administratës shtetërore, shërbimit civil, mjekëve, mësuesve apo kujtdo qoftë që do të siguronin dhe do të shkonin, vetëm në mbrëmje.

Gjatë numërimit, pas orës 7, tha z. Gjoshi, vendvotimet do të siguronin procesin e numërimit të votave si tip ndihme apo mbikëqyrje e tyre jo që do të kryenin vet numërimin por do të siguronin që votat do të numëroheshin mirë e para. E dyta, që është e domosdoshme kjo e dyta mendoj që ne ta paktën duhet ta lëshojmë një qarkore për gjithë komisionarët dhe ti bëjmë me dije që ata kanë përgjegjësi me i trajtuar subjektet, votat e kandidatëve në mënyrë të njëjtë, transparente mos ti numëron një person votat e kandidatëve por ti numëron ekipi i votimit ashtu siç e parasheh doracakun që vota është e mbrojtur si për parti si për subjekte politike edhe me kod penal trajtohet çdo mashtrim apo mos numërim i saktë si vepër penale pastaj e gjithë kjo mund të shoqërohet edhe me tërheqjen e vëmendjes gjitha këto mund ti numërojmë kutit apo mund ti rinumërojmë edhe për shkak të çdo pasaktësie dhe do të përfundojnë me kallëzime penale pran prokurorisë gjithë ata që nuk kanë numëruar të sakta. Dhe nja masë e tretë që unë mendoj që duhet të shikohet buxhetar, sekretariati është që gjitha ato vend votime të cilat nuk kanë problem me vota si për subjekte si për kandidat është mirë ndoshta të simulohen komisionarët ka shumë vende që e praktikojnë.

Kisha për t'i dhënë nga një bonus prej 20 euro gjithë atyre vendvotimeve që nuk kanë probleme, tha z. Gjoshi, dhe gjithë atyre që kanë probleme të mos të paguhet fare, ose ti zvogëlohet shuma e pagesës kjo mundet me qen një masë e cila konsideroj që mjaft shumë kishte me ndikuar në procesin e numërimit të saktë të votave, këto kanë qen idetë e mia që besoj munden me mi plotësuar edhe kolegët por e mira ka qen që sekretariati me përgatit një dokument i cili do të ishte i qartë mendoj që trijat janë të implementueshme, te triat janë ligjore, e dyta është domosdoshmëri ligjore edhe kanë koston nw qoftw se shtohen me elemente shitesë por nëse jo kjo e dyta si qarkore nuk ka ndonjë kosto por duhet me përcjell secilit komisioner. Personalisht duhet një nënshkrim që e ka pranuar për rendësin që e ka, pra me siguruar transparencë ne votim, numërim të saktë ne e kuptojmë ata që punojnë në orë ta gjata por nëse punojnë një orë ma shumë do të jenë rezultate më të sakta nuk është ndonjë punë e madhe. Faleminderit...

Valdete Daka: Mendoj qe janë të implementueshme këto...! Po, urdhëroni...?

Illir Gashi: Në fakt, e mbështes sidomos atë pjesën e qarkores qe e propozoj kolegu Betimi që t'ju përcillet komisionarëve dhe t'ju bëhet me dije që cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në vend votim. Dhe natyrisht që, kishte me qen mirë me pas masa shitesë sa i përket numërimit të votave sidomos asaj pjesës së numërimit për kandidat dhe komisionarëve t'i bëhet me dije që çdo problem i mundshëm që mund të ndodh në vend votim çdo kuti e cila bëhet objekt e rishqyrtimit të rinumërimit apo rivotimit nënkupton edhe pasjen e një vepre penale që ata komisionar do të ballafaqohen me ligjin dhe me pastaj edhe burgun e kanë të garantuar. Unë kërkoj, tha z. Gashi që ata të jenë të vetëdijshëm që mos bë bien pre e asnjë joshje qoftë ndonjë kandidati të mundshëm apo edhe subjekti politik sepse pastaj ata nuk do të shkoj as në burg ti vizitojnë, kështu që kërkojmë që të jenë të vetëdijshëm për punën dhe përgjegjësin që kanë marrë që procesi atë dit të shkoj në rregull pa probleme.

Binak Vishaj: Kryetare, me gjithë vullnetin dhe gatishmërinë që kemi ti aplikojmë secilat masat të cilat e kishin bo sa ma ta pa prekshëm, që nuk e cenojnë procesin e numërimit të votave mendoj dhe konsideroj që tash në këtë fazë që jemi dhe kohën që e kemi përpara është mjaft vështirë që ti aplikojmë këto dy masa tjera që i propozoj Betimi. E para, paraqet penges deri sa

mi përcaktu kush janë ata që do të jenë pjesë e mbikëqyrjes së numërimit ndërsa te tjetra ka kosto financiare që është mjaftueshëm e madhe që mendoj që nuk mundet me përballu sekretariati, sepse është praktik e mirë dhe është shumë e vërtet që ne kemi plot shtete demokratike këtë bonusin e këtyre njerëzve që punojnë saktë edhe respektojnë ligjin me pikmëni. Mendoj që kjo e dyta, pra shpërndarja e qarkores bëja me dije dhe vënja me theks të veçantë mbi përgjegjësinë edhe penalshmërinë, pjesën e ndëshkimit ata që e kanë përgjegjësi penale në rast se nuk i trajtojmë barabartë nuk i trajtojmë njëjtë fletëvotimin pa marrë parasysh se cilit subjekt dhe cilit kandidat ju ka jep atëherë ne do të jep pjesa tjetër ku do të jenë pjesë e hetimit. Mendoj që kjo është ajo që mundemi me bo e që nuk jemi keq me kohën e mundemi me implementu për mendimin tim, megjithatë vullnetin që kemi për me aplikuar cdo masë që këtë proces kishte me bo shumë më transparent.

Valdete Daka: Po Eshref. Urdhëro...!

Eshref Vishi: Po kryetare, ne e dimë se këshillat e vendvotimit janë përgjegjës për procesin e votimit dhe numërimit të votave në vendvotim i gjithë propozimi kishte të bënte me transparencën e procesit të numërimit të votave. Sa i përket votave për deputetët duke mos e anashkaluar se thjesht edhe votat e subjekteve politike mirëpo krejt qëllimi është që të rritet transparenca në leximin dhe evidentimin e votës në procesin e numërimit të votave. Doracaku, jep udhëzimet e mjaftueshme mirëpo krejt ajo që kërkojmë ne është e karakterit teknik që të rritet edhe më tej transparenca në këtë proces, d.m.th se ne, procesin e numërimit të votave ka alternativa ka propozime konkrete nuk ka nevojë sipas meje të shtohet numri i natarëve të këshillave të vendvotimeve në këtë aspekt mirëpo vetëm një angazhim i më shumë njerëzve të cilët e lexojnë votën atyre që, e evidentojnë votën dhe ata të cilët e plotësojnë raportin përfundimtarë të votave kështu që ne mundemi ti japim propozimet konkrete se qfar duhet të intervenohet në këtë pjesë të procesit të numërimit të votave.

Valdete Daka: Po Bajram...!

Bajram: Unë, në tërësi e përmbaj propozimin dhe diskutimin..., por në formë pllakati do të duhej të bëjmë apel, dhe se menjëherë kjo të bëhet me dije që të mbrohet zëri i partive, i kandidatëve...Dhe, të thirren të gjitha organet që, të njoftohen dhe se secili Qendër e Votimit, Vendvotim të thirret në përgjegjësi menjëherë...Pra, secili le t'i hapë sutë...

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare, c'është e vërteta, propozimin për të parën që të jetë nja nga shërbyesit civil që, do të mund të monitoronte nga pjesa tjetër, është ide shumë e mirë. Por, është e vërtetë që është pak vonë që të mund të implementohet. Ndërsa, dy tjerat mund të implementohen edhe e treta pse jo, edhe nëse e ka një kosto financiare. Por ideja, është më mirë këta që e tha Betimi që secilit ti ipet dhe të nënshkruaj ndoshta si kod etikës apo kod përfilljes që e ka pranuar secili dhe e din çfarë do të pason nëse ka lëvizje apo ka keq numërim apo keq përdorim të votës në vend, secili një kod të etikës mirësjelljes me nënshkruar po edhe e treta që te sanksionohen ata që kanë bërë shkelje në vend që mos të bëhet pagesa e tyre kurse të stimulohen ata që kanë bërë mirë, njëkoësisht të sjell edhe aty një efekt pozitiv. Edhe nëse e ka një kosto financiare uroj që gjithë ta kenë mirë se a i marrin 20 euro ajo nuk është një kosto e lartë që mundet me rrit koston e zgjedhjeve, e rrit me atë që të ketë një numërim të saktë të gjithë

e kemi të njëjtën gjithë anëtarët me konsensus atje një nga një e kemi përkrah idenë e Betimit, edhe duhet të bëhet. Po kjo e dyta duhet të bëhet gjithsesi për të tretën shihet por edhe ajo nuk është që nuk është e implementueshme.

Ilir Gashi: Faktikisht, nga rinumërimet e mundeshe që kanë ndodhur në zgjedhjet e kaluara kemi pasur, ku kemi rinumëruar komplet një komunë prej fillimit. Dhe mbi bazën e dyshimit që kanë bërë ankesa dhe diferenca në vota ka qenë edhe dy, do të thotë me nga dy vota nuk ka pasur më shumë që mund të jenë krejt gabime njerëzore dy vota, mirëpo gjithmonë defekti ka ndodhur te kandidatët pse ka ndodhur kjo, për arsye se votat e subjekteve politike po ruhen me fanatizëm! Dhe, kur po vjen pastaj deri te numërimi i votave të kandidatëve na duhet me marr masa që mos të lejohet që kryesuesi i vendvotimit të lejoj që votat e subjektit politik ti dhurohen përfaqësuesit të tij, ati tjetrit përfaqësuesit të vet. Por, rinumërimi i votave në vendvotim të bëhet bashkarisht me gjithë komisionarët, pavarësisht a merr kohë a nuk merr kohë se në shumicën e rasteve bëhet që të kryhet më shpejt procesi. Ne, për kandidat nuk kemi nevojë që të ngutemi për arsye se këtu po ndodh defekti, por numërimi të bëhet nga të gjithë, le të merr kohë sa të duhet nuk ka problem për kandidat po të bëhet nga të gjithë: jo të ndahen votat ti të subjektit tënd ti të subjektit tënd dhe nëse këtë e sanksionojm me një udhëzues të kryesuesit të vendvotimit dhe nëse ndodh e kundërta ka me mbajt ai përgjegjësi atëherë mendoj që këtu mund të dalim mirë duke e respektuar edhe vendimin, faleminderit.

Betim Gjoshi: Po mendoj që tash përveç këtyre që për pikën e dytë ka një pajtueshmëri, le ta shikohet edhe kjo e treta le ta shikohet ajo që tha Bajrami se edhe ajo nuk është ndonjë kosto se 2.500 vendvotime ka 2 pllakate të bëhen bëjnë 5.000 besoj që ka një vlerë të vogël, edhe me qenë me ngjyra nuk ndonjë problem të madh kanë kontratat këta kështu që le ta vijnë nesër me një propozim ta saktë por le ta merr përsipër krye shefi këtë qështje që deri nesër me përfunduar.

Valdete Daka: Kryeshef, deri nesër na tregon për këtë qarkore edhe për koston eventuale të këtyre pllakateve sepse kjo është ndoshta mënyra më e mirë që të citohen veprat penale të ju tërhiqet edhe të përgatitet një kod i mirësjelljes unë propozoj që ajo të nënshkruhet në ditën e zgjedhjeve në ora 7 ose në ora 6:30 kur janë aty gjithë komisionarët, ta nënshkruajnë këtë kod të mirësjelljes dhe etikës që do ti përmbahen edhe rregullave edhe ligjit. E caktojmë momentin që përgatitet nuk është problem, edhe që ajo të shpërndahet ajo qarkore duhet me përmbajt udhëzimin e saktë se çfarë janë vepra penale se sa do të sanksionohen për ato vepra penale dhe se të gjithë do të përgjigjen pavarësisht a janë kryesues apo çfarë janë edhe për votat e kandidatëve njësoj sikur votat e partisë. Edhe të nënshkruhet një kod i mirësjelljes a kemi nënshkrua përpara kod të mirësjelljes gjithmonë.

Enis Halimi: Këtë isha duke e thënë kryetare nëse me lejohet edhe ju është tërheq vërejtja për komisionerëve dhe është shpërnda një pjesë e kodit penal por tash mesa po kuptoj unë po vuhet theksi te votat e kandidatëve ndoshta dobësi. Meqë është vërejt më herët dobësi atëherë me vu theksin edhe këtu, për ndryshe mungesa të kodit penal ku sanksionohen një mori veprimesh.

Valdete Daka: Që njësoj janë të dënueshme sikur me i manipulu votat e partisë sikur me i manipuluar votat e kandidatëve, d.m.th, nuk ka dallim njësoj janë të dënueshme edhe që ne si

KQZ nuk do ta tolerojmë, edhe çdo rinumërim do të dërgohet si kallëzim penal kjo të vuhet një theks se çdo rinumërim do të jetë kallëzim penal.

Enis Halimi: Ne nesër do të bëjmë një propozim në tekst dhe e analizojmë edhe mundësin që secili, nesër e diskutojmë edhe në aspektin procedural edhe ju shpjegojmë se si e mendojmë shpërndarjen e kësaj fletushke ose si ta quajmë. Dhe po ashtu edhe për mundësin eventuale që të procedojmë idenë e zotit Latifi për me vendos një poster ta quajmë në çdo vendvotim.

Betim Gjoshi: Ne e kemi zakon me pas nga një raport për aktivitete sekretariatit besoj qe e kemi nesër nuk është ndonjë problem i madh. Mua më intereson vetëm krye shefi dhe menagjmenti a kanë ndonjë problem, ngecje deri tash mos keni ndonjë tejkalim për ndonjë çështjeje afatit kohor, mos keni ndonjë vonesë mundemi me pas sfidë sepse jemi ardhur edhe 5 ditë në zgjedhje.

Enis Halimi: Është kryesisht mirë procesi duke shkruar brenda mundësive që ofrohen në një situatë si kjo. Kemi ndoshta disa probleme më të theksuara gjatë vikendit në një komunë jemi përpjekur dhe jemi në përpjekje për ta zgjidhur lidhur me procesin e vijimit të trajnimit dhe të ndarjes së disa komisionarëve në disa subjekte. Ka probleme të kësaj natyre por jo ndoshta diçka si unifikonte që ja vlen të raportohet me një shqetësim, janë të zakonshme për këtë proces të madh në këto kohë të shkurtë.

Valdete Daka: Mirë edhe një njoftim të shkurt kisha pas për gjithë antarët se ju e dini që ne kemi bërë thirrje shumë instucioneve të shteteve përreth për vëzhgim të zgjedhjeve do ta kemi një pjesëmarrje të dukshme edhe nga shtetet përreth. Tashmë e kanë konfirmuar Maqedonia, Mali i zi, Bullgaria kemi edhe nga bota kemi nga Korea e Jugut do të kemi vëzhgues nga Afganistani nga Palestina...

Miradije Mavriqi: Deri më tani, janë akredituar deri tash me 4.887 vëzhgues deri më sot...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
